



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1102/H. Prot

Vlorë, më 28.07.2022

VENDIM
Nr. 29, datë 27.07.2022

PËR
PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUAR PËR STAFIN
AKADEMIK PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022"

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19, pika 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1003 prot, datë 15.07.2022 si dhe shkresës së Administratorit nr.1043 prot, datë 25.07.2022 "Përcjellje e efektit financiar, për pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27.07.2022.

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik për vitin akademik 2021-2022, për orët suplementare mbi 200-300 orë në auditor dhe jashtë auditorit të paraqitura nga Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore, përveç pagesës së mbingarkesës të orëve të udhëheqjes së temave të diplomës.
2. PAGESA E ORËVE TË UDHËHEQJES SË TEMAVE TË DIPLOMËS DO TË PAGUHEN PAS PËRFUNDIMIT TË PROCESIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 SI DHE PAS VERIFIKIMIT TË NUMRIT TË UDHËHEQJES SIPAS DEPARTAMENTEVE NË CDO NJËSI BAZË.
3. Ngarkohet Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për të llogaritur orët si dhe efektin financiar të mbingarkesës, pa mbingarkesën e orëve të udhëheqjes së temave të diplomës.
4. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF.AS.XHILIOLA AÇARAJ

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

